

2 Mobilizim sindikalist në Zvicër e Europë
Koha e fundit për rritje pagash

3 Zgjedhjet parlamentare 2023 në Zvicër
Islam Alijaj shkruan histori sukcesi


4 Ndërrimi i arkës së sigurimit shëndetësor
Si mund të kurseni në premitë e arkave

Nr. 6 | Nëntor 2023 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Kongresi i jashtëzakonshëm i Unia

Pensione më të mira, paga më të mira!



Olga Pisarek
Region Bern Oberaargau-Emmental
Région Berne Haute-Argovie-Emmental
Regione Berna Alta Argovia-Emmental



Pamje nga punimet e kongresit të jashtëzakonshëm të Unia: Prioritet pensione e paga më të mira dhe ulje të kohës të punës

Kongresi i jashtëzakonshëm i Unia u zhvillua me 21 tetor 2023 në Bernë. Rreth 300 delegatë vendosën mbi reformës statutare dhe mbi rezolutat e fushatave të rëndësishme të Unia: pensione më të mira, paga më të mira dhe një reduktim të orarit të punës me pagë të plote e kompensim personeli.

Emine Sariaslan

Në fjalën e saj të hapjes, presidentja e Unia, Vania Alleva shprehu tronditjen e saj për përshkallëzimin ndërkombëtar të dhunës. «Sa më shumë luftë e vuajtje që të kemi në botë, aq më shumë zotëron frika dhe aq më të lehte e ka e djathtë populiste me zgjidhjet e saja të rreme. Përgjigjet e saja cinike – ksenofobia dhe përjashtimi – gjithashtu krijojnë një siguri të rreme. Edhe këto gjithashtu qojnë në më shumë pabarazi dhe dhunë.» Më tej kryetarja e Unia e përshkroi si detyrën më urgjente të sindikatave dhënien e një kontributi konkret për drejtësinë sociale, veçanërisht në një botë që ka dalë jashtë kontrollit: «Në duhet të bëjmë gjithçka që është në mundësitë tona, për të përmirësuar para së gjithash jetën e njerëzve. Kjo është në përgjegjësinë tonë.»

Forcimi i demokracisë së anëtarëve

Për të forcuar demokracinë e anëtarëve u zhvilluan diskutime të shumta nëpër regjione me anëtarë dhe sekretarë. Nga këto rezultuan tri paketa reformash që përcaktojnë rrugën e rëndësishme për një riorganizim të punës sindikaliste. Paketa e parë e reformave synon të përfshijë më nga afër anëtarët aktivë vullnetarë në proceset e vendimmarrjes strategjike. Ndër të tjera, për ta siguruar këtë, delegatët vendosën për një përbërje të re të kryesisë qendrore. Dy paketa të tjera reformash kishin të bënin me hartimin dhe koordi-

nimin e njësive të brendshme organizative. Vendimet e delegatëve çojnë në harmonizim të butë në këto fusha, gjë që lejon integrimin dhe koordinimin më të mirë të shumëllojshmërisë së gjerë të komitetëve të sektorëve dhe regjioneve. Në votimin përfundimtar, 195 delegatë votuan për reformë, ndërsa 32 delegatë kundër dhe me disa abstenime.

Prioritetet e fushatës: pensione më të mira, paga më të mira dhe ulje të orëve të punës

Delegatët debatuan edhe mbi tri rezoluta, të cilat paraqesin prioritetet e fushatave të Unia për muajt në vijim. Rezoluta «rritje pensionesh, parandalim të shkurtimeve sociale» jep shenjën e fillimit të një fushate të bazës, në të cilën përqendrohet Unia në gjysmë vjetorin e parë 2024: për fuqizimin e pensioneve AHV/AVS, kundër zbrazjes së planifikuar të shtyllës së dytë (Arkës së pensioneve) dhe kundër rritjes së moshë së pensionimit.

Rritje pagash – pranim të diplomave dhe certifikimet të jashtë vendit

Me rezolutën «Forcimi të fuqisë blerëse në vend të maksimizimit të fitimeve», Unia dëshiron të rrisë pagat dhe të luftojë kundër shpërndarjes së padrejtë dhe kundër varfërisë. Nga njëra anë, pagat e mira

janë parakushti bazë për pensione më të mira; dhe nga ana tjetër, punëtorët e zakonshëm dhe pensionistët vuajnë një lloj nga mungesa e kompensimit për shtrenjtimin. Bazuar në këtë rezolute të dytë, Unia vitin e ardhshëm dëshiron të intensifikojë fushatën e saj të pagave: për rritje të përgjithshme pagash, paga minimale prej 4500 franga ose 5000 franga me kualifikim profesional, paga të barabarta për gratë, më shumë reduktime të primeve si dhe një pagë të 13-të mujore, një pension të 13-të AHV/AVS për të gjithë.

Olga Pisarek, në emër të strukturës së migrantëve të Unia, ka paraqitur mocion vijues: Tek rritja e pagave të përfshihet jo vetëm arsimimin profesional zviceran, por të merren parasysh edhe diploma dhe certifikata të fituara jashtë vendit. Edhe ky mocion u pranua.

Më shumë kohë për të jetuar

Delegatët miratuan gjithashtu dokumentin e titulluar «Është momenti i duhur për më shumë kohë për të jetuar!» pa asnjë votë kundërshtuese. Ky dokument kërkon një reduktim të fuqishëm të orëve të punës me pagë të plotë dhe kompensim të personelit. Jeta duhet të ketë përparësi para fitimit! Një shpërndarje e re e drejtë e punës është e mundur.

Editorial



Zgjedhjet federale përfunduan. Partia popullore e Zvicrës (SVP/UDC) edhe përkundër fushatës së saj raciste, fitoi 9 mandate shtesë. Kjo edhe për arsye se parullat e saj polemizuese e populiste thuajse nuk u kundërshtuan fare, qoftë nga frika apo nga kalkulimi për të mos ra në kurthin e saj. Siç shkruajnë edhe gazetaret në Gjermani, SVP/UDC shfrytëzoi kartën «Mëshojtu të huajve». Të paktën, këtë fushatë, e kundërshtoi Komisioni Federal kundër Racizmit. Ky komision përmes një shkresë i bëri thirrje udhëheqjes së SVP/UDC që të ndalojë fushatën raciste. Në vend që të distancohej nga kjo, SVP/UDC e bëri këtë reagim publik dhe e përdori për të nxitur atmosferën kundër komisionit në fjalë. Rezultatet e zgjedhjeve tregojnë edhe një herë qartë se, kur çështja e migracionit i lihet në dorë të djathtës, atëherë edhe u jepet atyre shansi që të kultivojnë narrativën sipas nevojave të tyre. Edhe pse ka pasur mjaft mundësi për të diskutuar aspektet pozitive të migracionit. Është pikërisht iniciativa e demokracisë, e cila ka dhënë material të mjaftueshëm për një diskutim rreth pjesëmarrjes në demokraci të migrantëve. Pastaj edhe mungesa e punëtorëve të kualifikuar, mungesë kjo e cila sipas të gjitha gjasave nuk mund të plotësohet pa migracionin. Forcat progresive janë të thirrura që të veprojnë, pasi që racizmi nuk duhet të kalojë pa u kundërshtuar. Meqë ra fjala: një e katërta e popullsisë nuk ka pas të drejtë vote. Fuqizimi i SVP/UDC-së nuk është premtues për sfidat me të cilat përballen punonjësit dhe shoqëria, si: fuqia blerëse, klima dhe politika sociale. Gjithçka po shtrenjtohet dhe fuqia blerëse po humbet, sepse pagat as që janë duke u rritur. Premitë e sigurimit shëndetësor janë në rritje. Gjithnjë e më shumë njerëz janë të shqetësuar për ekzistencën e tyre. Neve do të na duhet që të luftojmë edhe më fort dhe më me përkushtim për pagat, pensionet dhe të drejtat e njeriut.

Hilmi Gashi

News

Aksioni: 16 ditët kundër dhunës

Dhuna me bazë gjinore njihet shumë forma. Kjo është arsyeja pse çdo vit përqendrimi është në një temë të ndryshme. Kjo bën të dukshëm llojshmërinë e formave të dhunës dhe të atyre që preken nga dhuna. Mbi 40% e grave në Evropë janë të prekura nga dhuna psikologjike. 20% e grave kanë përjetuar imponimin të paktën një herë në jetën e tyre. Baza e kësaj dhune janë strukturat patriarkale, zhvlerësimi i grave dhe marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit. Këto struktura sociale çojnë gjithashtu në banalizimin e dhunës specifike gjinore. 16 ditët e veprimit zhvillohen çdo vit nga 25 nëntori deri më 10 dhjetor. Në vitin 2023, dhuna psikologjike do të jetë tema e përqendrimit. Le të punojmë së bashku për një shoqëri të pa dhunshme dhe ta bëjmë të dukshme dhunën e padukshme. www.16tage.ch/de/veranstaltungskalender

Largim masiv skandaloz në Spitalin Kantonal St. Gallen

Punonjësit e spitaleve St. Gallen u tubuan para hyrjes në spitalin e St. Gallen për të protestuar kundër shkurtimeve të mëdha të vendeve të punës dhe duke duartrokitën para deryve të punëdhënësve për saktësisht 4 minuta e 40 sekonda. Përkundër deklaratave për media të drejtuesve të spitalit, pritet të shkurtohen 120 pozita infermiere me kohë të plotë! Me aksionin e tyre para spitalit kantonal St. Gallen, punonjësit e spitaleve të St. Gallen kërkuar përgjegjëshmëri nga drejtuesit e spitalit dhe parlamenti kantonal dhe të ndalojnë menjëherë çdo shkurtim të vendeve të punës dhe të tërheqin largimet nga puna. Punonjësit po ashtu i bëjnë thirrje drejtuesve të spitalit që të punojnë së bashku për të zhvilluar zgjidhje të qëndrueshme në mënyrë që spitalet St. Gallen të mbeten një punëdhënëse tërheqëse.

Demonstratë për drejtësi klimatike



Të veprohet tani! Nën këtë slogan, mbi 60 000 njerëz demonstruan në Bernë më 30 nëntor 2023. Unia mori pjesë në demonstratën kombëtare të klimës sepse betejat ekologjike dhe sociale janë të përbashkësi. Përkeqësimi i emergjencës klimatike është rezultat i një ekonomie fitimi të shfrenuar, të bazuar në nafte. Dhe është një shprehje e pabarazisë ekstreme: nga njëra anë, korporatat e mëdha mbledhin fitime në industrinë e karburanteve fosile dhe super

të pasurit bëjnë një jetë luksoze me emetime të tmerrshme të konsumit. Nga ana tjetër, njerëzit në vendet më të varfra, si dhe punonjësit e personat e pa favorizuar social në mbarë botën vuajnë edhe më shumë nga pasojat e ngrohjes globale. Unia lufton për një transformim ekologjik që zvogëlon dhe jo që rrit pabarazitë: për një ristrukturim eko-social drejt neutralitetit të shpejtë të CO2 (dioksid karbonit) dhe një shpërndarje të drejtë të pasurisë, mundësive për jetë dhe punës së mirë.

Kantoni i Bernës dëshiron të zgjasë orarin e hapjes së dyqaneve

Qeveria kantonale e Bernës dëshiron të zgjasë orët e hapjes së dyqaneve në qendër të Bernës të shtunave. Edhe ashtu orari i punës në shitje është tashmë një tej ngarkesë për shumë punonjës. Prej tyre kërkohet një maksimum fleksibiliteti: detyrat e punës të fragmentuara dhe afatshkurtra, puna në mbrëmje dhe puna në fundjavë janë bërë përditshme. Është e papranueshme që orët e hapjes së dyqaneve të çrregullohen më tej. Votuesit në kantonin e Bernës gjithashtu e shohin atë në këtë mënyrë, pasi ata refuzuan një zgjatje të orarit të hapjes së dyqaneve në kutitë e votimit në mars 2021. Kjo do të thotë një përkeqësim për personelin e shitjeve, interesat e të cilëve fatkeqësisht nuk u morën parasysh nga qeveria kantonale. Kjo është e papranueshme për sindikatat dhe anëtarët e saj.

Ne jemi të zemëruar: Mobilizime në Zvicër dhe Europë
Koha e fundit për rritje pagash!

Shtrenjtimi, rënia e pagave reale, humbja e fuqisë blerëse dhe vjedhja e pensioneve po e bëjnë jetën të vështirë për punonjësit dhe pensionistët në Zvicër dhe në mbarë Europën. Kjo është arsyeja pse ata anembanë Evropës po dalin në rrugë për të luftuar për paga dhe pensione më të mira dhe kundër politikave shtrënguese të qeverive.

Marília Mendes

Pabarazia sociale në Evropë po rritet. Nga njëra anë po shpërthejnë fitimet e ndërmarrjeve të mëdha dhe të pasurit po bëhen edhe më të pasur. Nga ana tjetër, gjithnjë e më shumë punonjës dhe pensionistë nuk janë në gjendje të paguajnë faturat e tyre. Kjo pabarazi e bën jetën të vështirë dhe i zemëron punonjësit.

Bernë: Demonstratë për paga më të mira

«Pagat duhet të ngiten»: Me këtë moto më 16 shtator 2023 u tubuan rreth 20 000 njerëz në Bernë, për të shprehur pakënaqësinë e tyre për humbjen gjithnjë e më të dhimbshme të pagave. Ata kanë arsye për të qenë të zemëruar: Rritja e kostove për sigurimet shëndetësore, qirave, energjisë dhe mallrave të konsumit ngarkon për 3000 franga shtesë në vit buxhetet e familjeve të tyre. Shumë veta mezi ia dalin mbanë. Kjo situatë është edhe më e padurueshme, kur dihet se ekonomia po ecën mirë, produktiviteti po rritet dhe drejtuesit e lartë dhe aksionarët kryesorë po pasurohen paturpshëm: hendeku i pagave po zgjerohet vazhdimisht. Më në fund punëdhënësit duhet ta pranojnë këtë fakt dhe të rrisin pagat!

Lufta ia vlen: pagat e pastrimit rriten me 3%

Janë arritur përmirësimet në KKP për pastrim: partnerët kontraktualë të sektorit (shoqata e punëdhënësve Allpura dhe sindikatat Unia, Syna dhe VPOD) i kanë vendosur vetes si qëllim përmirësimin e punës në sektor dhe ofrimin e kushteve të mira të punës. Gjatë negociimit të marrëveshjes kolektive të pastrimit për Zvicrën gjermano folëse, u caktua rritje pagash për 2022 dhe 2024 me dy për qind për secilin vit. Tani partnerët kontraktualë po reagojnë ndaj shtrenjtimit, i cili po ngarkon fuqinë blerëse të punonjësve të pastrimit: ata kanë rënë dakord të rrisin pagat me tre për qind në vitin 2024. Partnerët kontraktualë kishin vendosur tashmë një rritje të jashtëzakonshme të pagave prej tre për qind në vitin 2023. Kjo do të thotë se paga minimale në pastrim në tre vjet do të rritet me tetë për qind.

KKP për elektrikistët dhe teknikët e ndërtimit

Nevojiten kushte si dhe paga më të mira pune

Marrë parasysh kushtet e vështira të punës, mungesën e fuqisë punëtore dhe nevojën për të planifikuar tranzicionin energjetik, elektrikistët dhe teknikët e ndërtimit në muajin tetor demonstruan në Cyrih. Ata bënë të qartë se cilat janë kërkesat e tyre për negociatat e KKP. Nga kjo KKP janë të prekur rreth 50 000 elektrikistë dhe teknikë ndërtimi.

Marie Saulnier Bloch

Demonstrata në Cyrih

Rreth 1200 elektrikistë dhe teknikë ndërtimi demonstruan më 7 tetor 2023 në Cyrih, për tu përcjellë punëdhënësve të tyre mesazhin e fuqishëm për negociatat e KKP-së: më shumë pagë, më pak presion dhe pensionim të më hershëm tani! Ata bënë të qartë se vetëm kushtet më të mira të punës zgjidhin problemin e mungesës së kuadrove dhe fuqisë punëtore dhe të sigurohet tranzicioni energjetik.

Mjaft më!

Ekspertët vlerësojnë se dhjetëra mijëra vende pune mungojnë për të rinuar ndërtesat, zëvendësuar sistemet e ngrohjes dhe instalimin e sistemeve diellore në kohën e duhur. Është koha që punëdhënësit të dëgjojnë punonjësit sepse gjërat vetëm mund të përkeqësohen. Lulëzimi i ndërtimit, por mungesa e punëtorëve, rritja e presionit të afateve dhe punonjësit vuajnë nga kushtet e vështira të punës dhe pagat që ngecin nën shtrenjtimin. Për ata që e duan punën e tyre, por të cilët shkatërrojnë kurrrizin dhe nuk kanë kushte të kënaqshme jetese, mjafton!

Më shumë pagë, më pak presion dhe pensionim të parakohshëm tani!

Punonjësit kërkojnë një rritje të përgjithshme pagash prej të paktën një për qind krahas kompensimit të shtrenjtimit. Orët

Manifestim: Për fuqizimin e pensioneve të AHV/AVS

Edhe pensionistët po hasin gjithnjë e më shumë vështirësi për të përballuar koston e jetesës me pensionet e tyre. Më 25 shtator, në një tubim për të shënuar 75-vjetorin e AHV/AVS-së në Bernë, 1200 pensionistë dhe sindikalistë kujtuan mandatin kushtetues të institucionit tonë më të rëndësishëm të mirëqenies sociale: të mbulojë në mënyrë adekuate nevojat e jetesës. Duhet rritur urgjentisht pensionet e AHV/AVS-së. Prandaj demonstruesit thanë: Po pensionit të 13-të të AHV/AVS-së.

Paris: Në lëvizje për paga më të mira

Sindikatat evropiane po kundërshtojnë gjithashtu pabarazisë në rritje me një fushatë vjeshte për paga dhe pensione më të mira, si dhe kundër paketave shtrënguese në kurrriz të popullsisë. Ndër të tjera, 20 000 punonjës nga e gjithë Europa u mbledhën në Paris më 13 tetor 2023 dhe kërkuar paga më të mira, barazi për gratë dhe fundin e politikave shtrënguese. Sindikata Unia, me delegacionin e saj, mori pjesë në këtë demonstratë.

Mobilizimet masive janë zhvilluar tashmë në mbi një duzinë vende këtë vjeshtë nën sloganin e Sindikatave të Bashkuara Evropiane (EGB/ETUC) «Në rrugë për një marrëveshje të drejtë për punëtorët». Për më shume informacion shih edhe: www.etuc.org/en/road-fair-deal-workers

shtesë të punës duhet të jenë të kufizuara dhe punonjësit duan të mund thonë se kur dhe si mund të kompensojnë orët shtesë. Ekziston gjithashtu një nevojë që të zgjidhet urgjentisht pensionimi i parakohshëm, i cili do tu mundësonte atyre të përmbyllin me dinjitet karrierën e tyre profesionale.

Dy peticione dhe një demonstratë e madhe

Demonstruesit i paraqitën këto kërkesa në selinë kombëtare të shoqatave të punëdhënësve «EIT. Swiss» (elektriciteti) dhe «Suissetec» (tek-

nologji ndërtimi). Të 7883 nënshkrimet e mbledhura dhe demonstrata luftarake në tetor tregojnë qartë se punëdhënësit duhet të ndërmarrin masa tani.



Foto: Lucas Dubois



Foto: Manu Friedrich

Angazhimi sindikalist kundër trafikimit me qenie njerëzore

Duhen masa konkrete për sensibilizim e luftim të trafikimit

Ajo që mund të duket e çuditshme në shikim të parë është fatkeqësisht e vërtetë: trafikimi i qenieve njerëzore ndodh edhe në Zvicër dhe rastet e raportuara vazhdojnë të rriten. Unia e ka trajtuar këtë çështje dhe është përfshirë si partner social në Planin e 3-të Kombëtar të Veprimit kundër Trafikimit të Njerëzve (2023-2027). Më 23 tetor 2023, në selinë qendrore të Unia-s, në Bernë, u zhvillua simpoziumi kundër trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim shfrytëzimi si fuqi pune.



Unia angazhohet për ndalimin e trafikimit të njerëzve dhe shfrytëzimin çnjerëzor të tyre

Trafikimi i qenieve njerëzore – cilat janë problemet?

Çdo ditë në Zvicër njerëzit shfrytëzohen dhe duhet të punojnë në kushte çnjerëzore. Edhe pse rastet mund të duken të vogla në krahasim me vendet e tjera, rastet ekzistojnë – dhe ato janë në rritje të vazhdueshme. Nëse, sipas «Plateforme Traite», në vitin 2019 ka pasur 255 raste të raportuara, në vitin 2022 kemi tashmë 375 raste. Dhe fatkeqësisht duhet të supozohet se numri i rasteve të pa raportuara është shumë më i lartë. Sepse shumica e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore ndodhin në fshehtësi. Ka disa arsye për këtë: shpesh shumica e të

prekurve varen nga punëdhënësit e tyre, nuk flasin gjuhën vendase dhe për këtë arsye nuk janë në gjendje të mbrohen. Shumica e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për punë dhe punës së detyruar përfshijnë para së gjithash të huajt dhe shpesh të prekurit nuk kanë status të rregullt qëndrimi ose leje të dërguarish. Ata kanë frikë se mos kriminalizohen nëse shkojnë tek autoritetet, sepse në Zvicër nuk ka mbrojtje gjithëpërfshirëse të viktimave. Një faktor tjetër ndërlikimi është se të prekurit zakonisht kanë pak ose aspak njohuri për situatën e tyre ligjore dhe nuk dinë si të mbrohen.

Broshura e Unia

Për të dhënë një kontribut përkitazi me mungesën e njohurive dhe pasigurinë për temën e trafikimit të qenieve njerëzore dhe punës së detyruar, Unia botoi një broshurë të përpunuar posaçërisht në simpozium që tërheq vëmendjen mbi temën, për të sensibilizuar publikun dhe punëdhënësit dhe për të ofruar ndihmë për të prekurit. Për shkak se është e ankoruar mirë në sektorë të ndryshëm të punës, Unia luan një rol të rëndësishëm në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, thotë presidentja e Unia, Vania Alleva. Angazhimi i Unia-s plotëson punën e organizatave anëtare të platformës kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Vetëm përmes edukimit dhe sqarimit aktiv mund të hidhet dritë mbi të fshehtat dhe numrin aktual të rasteve të zbuluara. Kjo është e rëndësishme në mënyrë që të ndërgjegjësohet publiku dhe politikanët se trafikimi i qenieve njerëzore dhe puna e detyruar ndodh çdo ditë në Zvicër dhe se duhet të merren masat e nevojshme në përputhje me rrethanat.

Informacione të mëtejme mbi temën gjeni në vijim: www.unia.ch/menschenhandel

Imran Sariaslan

Konferenca pjesëmarrje në vend të përjashtimit

Kërkohet zbatim i një politike migracioni të bazuar në solidaritet

Rreth 60 persona nga gati 20 organizata të lëvizjes së migrantëve e sindikaliste u takuan me 23 shtatore 2023 në Bernë në konferencën «Pjesëmarrje në vend të përjashtimit», për të zhvilluar kërkesat e përbashkëta për një politikë solidare migracioni. Ndër pjesëmarrësit ishin edhe shumë kolege e kolegë të Unia.

Hilmi Gashii

Në prag të konferencës, organizatat Solidarité sans frontières (Sosf), VPOD, Unia dhe solinetze.ch, së bashku edhe me organizatat tjera që punojnë në fushën e azilit dhe migracionit, kishin diskutuar tezat dhe kërkesat në katër fokus-grupe mbi temat për lirinë e lëvizjes, regjimet kufitare, të drejtat e qëndrimit, legalizimin, pjesëmarrjen ekonomike, sociale dhe politike, si dhe luftimin e racizmit të përditshëm dhe strukturor. Këto tema të konferencës në fjalë, në formë të kumtesave të pozicionimit, u diskutuan, u plotësuan dhe u miratuan.

Rezistenca ndaj heqjes së të drejtës fare pak e dukshme

Puna në kumtesa si dhe diskutimi në fokus-grupe si dhe në konferencë dhe me rastin e shkëmbimit mes njëri-tjetrit tregoi se po bëhet rezistencë e rëndësishme ndaj heqjes së të drejtës në rritje në sistemin e migracionit dhe azilit. Një problem qendror është se kjo rezistencë dhe kritika ndaj regjimit të migracionit në diskursin e mediave mezi merret parasysh. Zgjidhjet dhe sugjerimet e bëra nga grupet progresive të bazës shpesh injorohen. Media shumë shpesh përvetëson diskursin e politikanëve të djathtë borgjez, pa e reflektuar sa duhet atë diskurs.

Një politikë solidare është e mundur dhe e nevojshme

Pjesëmarrësit në konferencë formuluan kërkesa konkrete bazuar në përvojat e tyre dhe përditshmëria luftarake. U parashtruan kërkesa vijuese: lufta e përbashkët kundër

dhunës shtetërore me rastin e debimeve. Dhënia fund i shfrytëzimit për punë të migrantëve – të drejta të njëjta për të gjithë! Të luftohet varfëria, e jo të varfëritë. Marrja e ndihmës sociale nuk duhet të çojë në heqjen e lejes së qëndrimit dhe një ndryshim paradigme në çështjen e të drejtave qytetare e përmes të drejtave të bashkëvendosjes politike për refugjatët dhe migrantët!

Lufta në aleancë të zgjeruar

Reduktimin e të drejtave themelore të migrantëve mund ta ndalim vetëm së bashku. Kjo konferencë është një fillim i mirë i mobilizimit për pjesëmarrje më të mirë për të gjithë njerëzit në Zvicër. Pas këtij fillimi të suksesshëm, është e rëndësishme të rritemi dhe të zbatojmë një politikë migrimi në Zvicër të bazuar në solidaritet.



Reduktimin e të drejtave themelore të migrantëve mund ta ndalim vetëm së bashku.

Aktivisti Islam Alijaj



Zgjedhjet parlamentare 2023 në Zvicër

Islam Alijaj shkruan histori

Aktivisti i palodhshëm për përfshirje në shoqëri dhe jete politike edhe të njerëzve me aftësi të kufizuara, Islam Alijaj shkroi histori duke u zgjedhur deputeti i parë shqiptaro-zviceran në parlamentin e konfederatës zvicerane. Krahas Islamit, kandidat për parlamentin zviceran ishin edhe rreth 30 shqiptaro-zviceran tjerë.

Islam Alijaj është i mirënjohur si drejtues i «revolucionit të personave me aftësi të kufizuara» në Zvicër. Ai nga përvoja personale e tij, një dhe e dinë se çka domethënë me qenë i përjashtuar nga përditshmëria «normale» për shkak të handikapit. Miqtë dhe bashkëpunëtorët e tij, Islamit e njohin si njeri me shumë energjinë pozitive, i cili dallohet për humorin dhe inteligjencën e tij të jashtëzakonshme. Ai është treguar prore solidar me grupet e marginalizuara, migrantët dhe punëmarrësit, andaj ka fituar simpatinë, respektin dhe mbështetjen e tyre.

Islam Alijaj pas lindjes nuk ka pas mjaft oksigjen dhe si pasojë kësaj është përballur me vështirësi në të ecur dhe të folur. Por truri i punon palodhshëm. Synimi i tij politik është një shoqëri (gjithë)përfshirëse (inklusive). Një shoqëri gjithëpërfshirëse fokusohet në potencialin e individëve. pra, aftësitë e jo mangësitë secilit janë të rëndësishme.

Veprimtari shoqëror dhe politikan Islam Alijaj zhvilloi një fushatë zgjedhore shembullore dhe arriti të përfitoi shumë mbështetës. Në zgjedhjet parlamentare federale të Zvicrës, të zhvilluara me 22 tetor 2023, Islam Alijaj mori 95 054 vota, që i siguruan ulësen në parlamentin zviceran, me çka thyen akullin dhe hap perspektiva për politikan tjerë shqiptaro-zviceran. Për këtë të arritur nuk mungoi, para së gjithash, edhe mbështetja e aktivistëve sindikalistë shqiptaro-zviceranë të Unia Regjioni Cyrih me në krye Xhafer Sejdiun dhe Qendrës «Parandalo» të Cyrihut me në krye Valdete Hotin.

Rrugëtimi i angazhimit dhe përkushtimit shoqëror e politik të Islam Alijajt tregon se cila është rruga që duhet ndjekur për të arritur suksese deri edhe historike, edhe përkundër pengesave fizike e shëndetësore, por edhe i atyre të natyrës strukturorë e institucionale. Andaj, rëndësia e zgjedhjes së shqiptaro-zviceranit të gjeneratës së dytë dhe si njeri me aftësi të kufizuara është shumë e madhe dhe inkurajuese edhe për të gjithë njerëzit tjerë që nuk përballen me parakushte të tilla kufizuese sikur Islami. Kjo flet edhe për mundësitë që ofron Zvicra, përkundër mangësisve të caktuara demokratike kur është fjala për migrantët dhe grupeve të ndryshme të stigmatizuara.

<https://islamalijaj.ch/>

Osman Osamani

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Anulimi i pagesës së mëditjeve të sëmundjes: A është kjo e mundur?

Unë punoi qe 15 vite si murator për një ndërmarrje ndërtuese. Puna është e rëndë fizikisht. Unë ka vite që kam dhimbje kurrizi. Para disa muajsh pësova lëndim të shtyllës kurrizore dhe që nga ajo kohë jam i paafat për punë. Unë përfitoj nga sigurimi i parave të mëditjeve në rast sëmundjeje. Sigurimi në fjalë tani më shkruar se do të ndalë pagesën e mëditjeve shkaku i dëftesës mjekësore të mjekut të besuar të sigurimit, pasi unë do të mund të isha i aftë 100% për një punë tjetër, e cila nuk do të ishte rëndë për mua dhe ku unë pjesërisht do të mund të punoja ulur. Mjeku im personal gjithashtu ka mendim të ngjashëm. Megjithatë: A lejohet që sigurimi i mëditjeve në rast sëmundjeje papritur të mi anulohet përfitimet?



SHPINA E THYER, Job Futsch: Pas një lëndimi të shtyllës kurrizore për një murator parashi-het ndërimi i profesionit. (Foto: Keystone)

Regula Dick: Po, edhe nëse kjo mundësi nuk është theksuar qartë në kontratënJo. Sigurimi i parave të mëditjeve kërkon nga ju ndërrimin e profesionit shkaku i zbutjes së detyrueshme të dëmit – kjo domethënë, që ju si i prekur nga aksidenti dëmet e shkaktuara dhe pasojat vijuese duhet të zvogëloni për aq sa është e mundur. Kjo në parim edhe është e lejuar, mirëpo gjykata federale ka vendosur, që sigurimi i mëditjeve duket me kohë të paralajmërojnë këtë. Sigurimi në fjalë duhet juve tu ofrojë një afat kalimtar nga 3 deri 5 muaj dhe gjatë kësaj kohe të paguaj normalisht më tej paratë e mëditjeve. Kjo vlen edhe atëherë, kur marrëdhënia e punës mes jush dhe ndërmarrjes ndërtimore në ndërkohë ka përfunduar.

(Work, 1.9.23)

Dështimi gjatë kohës së punës provuese. A paguan sigurimi aksidental?

Në ditën time të dytë të punës në një furrë buke më ka therur një bletë. Duke qenë se jam alergjik ndaj helmit të bletës, më është dashur të shkoj menjëherë në urgjencë. Unë më pas nuk kam mund të punoja për një javë. Meqenëse isha në periudhën e punës provuese, nuk kisha ende të drejtë ligjore për vazhdimin e pagesës së pagës gjatë sëmundjes. Mjerisht, ne nuk kemi sigurim të përfitimit të mëditjeve në rast të sëmundjes. Tani një koleg më tha se sigurimi i aksidenteve do të më paguante mëditjen. A qëndroni kjo?

Regula Dick: Po, parë ligjërisht, thumbimi i bletës është në fakt një aksident. Ka një efekt dëmtues në trup që nuk pritet dhe që është – siç thotë ligji – i pazakontë (ASTG Neni 4). Prandaj, përkufizimi i rastit të aksidentit në rastin tuaj plotësohet. Për të marrë përfitimet e mëditjeve të aksidentit, duhet të bëni një raport aksidenti. Sigurimi mbulon kompensimin e mëditjeve nga dita e 3-të dhe paguan edhe shpenzimet mjekësore. Ndryshe nga rasti i sëmundjes, ju nuk do të merrni përsipër asnjë zbritje.

(Work, 1.9.23)

Dorëheqja shkaku i sëmundjes: A jam i mbrojtur gjatë periudhës së punës provuese?

Qe dy muaj që punoj në një punë të re. U sëmura dhe punëdhënësi më dha dorëheqje për në fund të muajit me një afat prej shtatë ditësh. Brenda një jave unë nuk do të kam më të ardhura dhe nuk mund të gjej një punë të re. I shkrova punëdhënëses se kisha dëgjuar se kishte mbrojtje kundër pushimit nga puna dhe se ajo nuk mund të më nxirrte në rrugë kur isha i sëmurë. Ajo u përgjigj se isha ende në periudhën time të punës provuese dhe se për këtë arsye ajo mund të më ndërprisë kontratën me një periudhë të shkurtër njoftimi prej shtatë ditësh. A është kjo e ligjshme?

Marina Wyss: Mjerisht po. Tek pas periudhës së punës provuese ju mbroheni nga dorëheqja gjatë të ashtuquajturës periudhë bllokuese. Sipas të drejtës obligative, muaji i parë konsiderohet periudhë prove, edhe pse me kontratë mund të bihet dakord për një periudhë më të gjatë prove, por kjo nuk mund të zgjasë më shumë se tre muaj. Pra, duhet të kontrolloni kontratën tuaj të punës ose KKP-në: Nëse është rënë dakord për një periudhë prove prej, për shembull, tre muaj, përfundimi me njoftim shtatë ditë është i ligjshëm dhe nuk mbroheni nga largimi nga puna për shkak të sëmundjes. Ju do të merrni ende përfitime mëditjesh nga sigurimi i papunësisë për një periudhë të kufizuar kohore, kështu që duhet të regjistroni atje në çdo mënyrë. Nëse kontrata juaj e punës nuk thotë asgjë për kohëzgjatjen e periudhës së provës, sipas ligjit vetëm muaji i parë konsiderohet periudhë prove.

(Work, 15.9.23)

Arka e sigurimit shëndetësor

Si mund të kursejë në preminë shëndetësore?

Shumica e njerëzve që jetojnë në Zvicër duhet të kenë marrë një njoftim nga kompania e tyre e sigurimeve shëndetësore me informacion e premive për vitin 2024. Vitin e ardhshëm duhet paguar mesatarisht 8.7 për qind më shumë për sigurimet shëndetësore. Çfarë mund të bëhet për të kursyer në premitë?

Pavarësisht nëse ka rritje apo jo, të gjithë të siguruarit mund të japin dorëheqje nga kompania përkitazi me sigurimin bazë shëndetësor deri në fund të nëntorit. Më tej gjithashtu është e mundur të kërkohet rritja e franshizë ose ndryshimi i llojit e sigurimit.

Ndërrimi i kompanisë së sigurimit shëndetësor

Nëse vendosni të ndryshoni sigurimin shëndetësor, ju lutemi vini re se afatet dhe kushtet për sigurimin bazë dhe sigurimin shtesë nuk janë identike. Informacioni i mëposhtëm vlen për ndryshimin në sigurimin bazë ligjor. Nëse dëshironi të ndryshoni sigurimin shtesë, duhet të pyesni kompaninë tuaj të sigurimit shëndetësor se cilat kushte dhe afate duhet të respektoni.

Dorëheqja nga kompania aktuale e sigurimit shëndetësor

Informoni kompaninë tuaj aktuale të sigurimeve shëndetësore me shkrim – mundësisht me postë të rekomanduar – se po i jepni fund kontratës me kompaninë të sigurimit tuaj shëndetësor (sigurimi bazë) që nga 31 dhjetori 2023. **Ju lutemi vini re se shkresa e dorëheqjes duhet të arrijë kompaninë tuaj aktuale të sigurimit shëndetësor deri më 30 nëntor.** Për vlefshmërinë e dorëheqjes, nuk ka rëndësi data e vulës postare, por data në të cilën shkresa është marrë nga kompania e sigurimit shëndetësor. Prandaj është e këshillueshme që letrën ta dërgoni mjaft herët për t'iu përmbajtur periudhës së njoftimit.

Lajmërimi tek kompania e re sigurimit shëndetësor

Ju mund të krahasoni oferta të ndryshme kur zgjidhni kompaninë tuaj të re të sigurimit shëndetësor. Ka disa shërbime krahasimi në internet si www.priminfo.admin.ch/de/paeremien. Kjo faqe interneti jo vetëm që ofron një llogaritës kontributi, por edhe shumë informacione të dobishme dhe shkresa mostër (shembull). Sapo të keni bërë zgjedhjen tuaj, informoni kompaninë e re të sigurimit shëndetësor se dëshironi të bëni sigurimin bazë me ta. Në lidhje me këtë, është e rëndësishme të dini se asnjë kompani e sigurimit shëndetësor nuk mund të refuzojë të keni tek ta sigurimin e detyrueshëm shëndetësor. Përveç kësaj, ndryshe nga sigurimi shtesë, kompania e re e sigurimeve shëndetësore nuk mund t'ju detyrojë të plotësoni pyetësorin për shëndetin tuaj. **Ju lutemi vini re, megjithatë, se ju mund të ndryshoni kompaninë e sigurimit shëndetësor vetëm nëse nuk keni ndonjë faturë të papaguar me kompaninë tuaj aktuale të sigurimit shëndetësor.** Pra, nëse nuk jeni të përditësuar me faturat tuaja dhe dëshironi të ndërroni kompaninë e sigurimeve shëndetësore, është e rëndësishme që të paguani çdo faturë të papaguar sa më shpejt që të jetë e mundur.

Vërtetim që jeni i siguruar në kompaninë e përzgjedhur të sigurimeve shëndetësore

Ju do jeni të siguruar në arkën e re shëndetësore sapo ajo të ketë informuar arkën tuaj të mëparshme për ndërrimin. Nëse arka e juaj e mëparshme nuk ka marrë asnjë njoftim deri në fund të vitit, ju do të mbeten të siguruar po në arkën tuaj të mëparshme. Prandaj është e këshillueshme që të siguroheni që arka e re të bëjë informimin përkatës tek arka juaj e mëparshme.

Rritja e franshizës

Franshiza është shuma që personi i siguruar duhet të paguajë për shpenzimet e tij të kujdesit shëndetësor çdo vit. Nëse shuma e franshizës është përdorur, kompania e sigurimit shëndetësor do të paguajë kostot e mbetura, në varësi të vetë mbulimit (10% deri në më së shumti 700 CHF në vit). Ju mund ta zgjidhni vetë shumën e franshizës. Me një franshizë të lartë, premitë janë më të lira. Me një franshizë të ulët, premitë janë më të shtrenjta. Franshiza përmban

Ulja kantonale e premive: Kontrolloni nëse keni të drejtë për një ulje të premisë!

Personat me të ardhura të ulëta kanë të drejtën e uljes së premive për sigurimin shëndetësor bazë. Kërkesat, shumica e uljes së premisë dhe procesi i aplikimit ndryshojnë nga kantoni në kanton. Ju mund të gjeni informacionin e nevojshëm – duke përfshirë adresat e institucioneve përgjegjëse kantonale në www.priminfo.admin.ch/de/versicherungen/verbilligung.

të paktën 300 franga dhe mund të rritet gradualisht deri në 2500 franga. Për shkak se me një franshizë prej 2500 merrni një rrezik kostojë më të lartë, andaj do të paguani premi më të ulët. Nëse në fund të fundit do t'ju bie më lirë me një franshizë më të lartë, varet nga kostot efektive mjekësore në vitin e ardhshëm. Për njerëzit që janë të shëndetshëm dhe rrallë shkojnë te mjeku, franshiza më e lartë prej 2500 frangash mund të jetë e leverdishme. Nëse keni probleme shëndetësore dhe duhet të shkoni rregullisht te mjeku, zakonisht është më mirë të merrni franshizën minimale prej 300 frangash.

Kufizim në përzgjedhjen e mjekut

Me sigurimin bazë, të siguruarit janë të lirë të zgjedhin mjekun e tyre – përfshirë specialistët. Megjithatë, kompanitë e sigurimeve shëndetësore ofrojnë modele kursimi me emërtime të ndryshëm, në të cilat të siguruarit janë të kufizuar në zgjedhjen e mjekut. Mund të kurseni premitë duke zgjedhur një nga modelet e kursimit. Variantet e mëposhtme zakonisht është e mundur për ti përzgjedhur:

Modeli i mjekut familjar

Me këtë model ju merrni përsipër të konsultoheni fillimisht me mjekun e familjes sa herë që sëmuren. Ai ose ajo do të vendosë nëse është e nevojshme t'ju referojë te një specialisti.

Modeli «HMO»

Ngjashëm me modelin e mjekut të familjes, gjithmonë duhet të shkoni te mjeku juaj në praktikën HMO, nëse keni ndonjë pyetje ose ankesë mjekësore. Nga atje, nëse është e nevojshme, ju do të udhëzoheni te specialistët.

Këshillimi telefonik

Kompani të ndryshme sigurimesh shëndetësore ofrojnë gjithashtu një model sipas të cilit duhet fillimisht të kontaktoni një linjë telefonike mjekësore në rast të pyetjeve mjekësore dhe/ose problemeve shëndetësore.

Vërejtje: Në raste urgjente, në përgjithësi nuk duhet t'iu përmbaheni këtyre udhëzimeve – kjo vlen për të gjitha modelet e kursimeve. Zakonisht nuk keni nevojë për një referim për të vizituar një ginekolog ose okulist (mjekë të syve). Por kini kujdes: nëse dikush merr trajtim mjekësor pa urgjencë ose pa rekomandim nga mjeku i familjes ose nëse ka harruar të telefonojë paraprakisht në linjën telefonike, mund të kushtojë shtrenjtë. Varësisht nga kompania juaj e sigurimit shëndetësor, ju mund të merrni vetëm një paralajmërim, por gjithashtu mund t'ju duhet të mbulonit vetë të gjitha shpenzimet e trajtimit. Prandaj është e rëndësishme, kur ndryshoni modelin tuaj të sigurimit, të shqyrtoni me kujdes se çfarë duhet të bëni e si duhet të veproni në rast të problemeve shëndetësore.

